



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilaški Savet Kosova/ Kosovo Prosecutorial Council

Këshilli Prokurorial i Kosovës në bazë të nenit 4 paragrafi 1.27 dhe 1.21 të Ligjit nr.03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.83 publikuar me dt.29 tetor 2010) dhe nenit 5 paragrafi 1.4 të Ligjit Nr. 05/L-035 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.17 e publikuar më 30 qershor 2015) në mbledhjen e mbajtur më 05 nëntor 2015 miraton:

R R E G U L L O R E NR. 05 / 2015

**PËR PUNËN E KOMISIONIT DISIPLINOR DHE PROCEDURËN DISIPLINORE
NDAJ PROKURORËVE**

Neni 1
Qëllimi

Kjo Rregullore përcakton organizimin dhe funksionimin e Komisionit Disiplinor si komision i përhershëm i Këshillit Prokurorial të Kosovës(tutje KPK), si dhe procedurën disiplinore që zhvillohet ndaj prokurorëve.

Neni 2
Fushëveprimi

Rregullorja do të përcaktoj rregullat e procedurës disiplinore që zhvillohen ndaj prokurorëve, të iniciuara nga Zyra e Prokurorit Disiplinor(tutje ZPD).

Neni 3
Përkufimet

Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:

"KPK" Këshillin Prokurorial të Kosovës;
"ZKPSH" Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit;
"LKPK" Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës;
"KPSH" Kryeprokurori i Shtetit;
"PSRK" Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës;
"PA" Prokurorinë e Apelit;
"PTH" Prokurorinë Themelore;

"ZPD" Zyra e Prokurorit Disiplinor;
"KD" Komisionin Disiplinor Prokurorial;
"Kryesues" Kryetari i Komisionit Disiplinor;
"Sekretar" Sekretarin e Komisionit Disiplinor;

Neni 4 **Përgjegjësitë e Komisionit**

4.1 Komisioni Disiplinor, si komision i përhershëm është përgjegjës që të:

- 4.1.1 Shqyrtojë të gjitha çështjet disiplinore ndaj prokurorëve të iniciuara nga ZPD-ja;
- 4.1.2 Zhvillojë seanca disiplinore ndaj prokurorëve pas paraqitjes së raportit nga ZPD-ja;
- 4.1.3 Shqipton masat disiplinore ndaj prokurorëve në KPK;
- 4.1.4 Kryen detyra të tjera nga fushveprimi i tij me kërkesë të KPK-së.

Neni 5 **Përbërja e komisionit**

- 5.1 KPK-ja cakton Komisionin Disiplinor në përbërje prej tre (3) anëtarëve si në vijim:
 - 5.1.1 një prokuror anëtar i Këshillit i cili do të jetë kryesues i komisionit,
 - 5.1.2 një anëtarë prokuror nga ZKPSH,
 - 4.2.3 një anëtarë prokurorë nga Prokuroria e Apelit.
- 5.2 Për shkak të natyrës së punës dhe pozitës, anëtarë të komisionit nuk mund të jenë:
 - 5.2.1 Kryesuesi i KPK-së,
 - 5.2.2 Kryeprokurori i Shtetit,
 - 5.2.3 Anëtar i këshillit nga radhët e avokatëve.
- 5.3 KPK me shumicë të votave zgjedhë anëtarët dhe kryesuesin e komisionit sipas nenit 5 të kësaj rregullore.

Neni 6 **Përgjegjësitë e kryesuesit të komisionit**

- 6.1 Kryesuesi i komisionit, përveç tjerash ka edhe këto kompetenca:
 - 6.1.1 organizon punën e përgjithshme të Komisionit;

- 6.1.2 përgjigjet para Këshillit për veprimtarinë e Komisionit;
- 6.1.3 autorizon anëtarët dhe sekretarin për ushtrimin e detyrave;
- 6.1.4 nënshkruan vendime, akte dhe shkresa të tjera;
- 6.1.5 planifikon programin e punës;
- 6.1.6 thërret mbledhjet dhe i udhëheq ato;
- 6.1.7 çdo 6 muaj përgatit raport mbi punën e komisionit;
- 6.1.8 përgatit raportin vjetor dhe ia paraqet Këshillit për aprovim;
- 6.1.9 kryen punë të tjera të përcaktuara me Ligj, Rregullore dhe sipas kërkesës së Këshillit/ Kryesuesit të Këshillit.

Neni 7

Anëtarët rezervë të komisionit

- 7.1 Këshilli zgjedh nga radhët e prokurorëve anëtarë rezervë për secilin anëtarë të komisionit.
- 7.2 Sekretari i komisionit mban evidencë për këtë çështje.

Neni 8

Sekretari i komisionit

- 8.1 KPK cakton një nga zyrtarët e sekretariatit të këshillit të shërbej si sekretar i komisionit.
- 8.2 Sekretari kryen të gjitha veprimet e nevojshme administrative në mënyrë që puna e komisionit të jetë funksionale. Për punën e ti, sipas nevojës koordinohet me Kryesuesin e komisionit.
- 8.3 Sekretari mban evidencë përkitazi me rrjedhën administrative të lëndës gjatë procedurës. Evidenca përfshinë regjistrimin e të dhënave nga momenti i pranimi të Raportit e deri në përfundimin e saj.
- 8.4 Sekretari e informon menjëherë kryesuesin me të pranuar një raport të ZPD.
- 8.5 Çdo lëndë duhet të ketë një numër si në vijim: KPK/KD/ numri i lëndës/ viti kalendarik (Shembull: KPK/KD/01/2015).
- 8.6 Me kërkesën e Kryesuesit, sekretari ka për obligim të asistoj përpilimin e vendimeve të komisionit.
- 8.7 Sekretari kujdeset që lëndët të paraqiten para komisionit sipas radhës me përjashtim të rasteve të natyrës urgjente. Për raste të tilla koordinohet me kryesuesin.

8.8 Në rastin e ankesës ndaj vendimit, kujdesët që lënda e kompletuar dhe pa vonesë të dërgohet në Këshill për vendosje.

8.9 Në rast se sekretari pengohet ta kryej detyrën e tij, caktohet një zyrtar ligjor tjetër që ta ushtroj detyrën derisa të shmangen pengesat.

Neni 9

Veprimet e administratës së KPK-së përkitazi më raportin e ZPD

9.1 Administrata e Këshillit, pasi ta pranojë raportin e ZPD-së menjëherë e dërgon në kompetencë të Komisionit disiplinor. Sekretari kryen detyrat administrative në koordinim me Kryesuesin. Sekretari kujdeset që prokurori ndaj te cilit është rekomanduar masa të ketë:

- a. Një kopje të shkresave të lëndës.
- b. Njoftimin lidhur më të drejtën për të përfaqësuar veten e tij apo të përfaqësohet nga një avokat.
- c. Njoftimin më shkrim lidhur më të drejtën e qasjes së plotë në dosjen disiplinore me vlerësim të arsyeshëm gjatë orarit të rregullt të punës.

9.2 Prokurori brenda pesëmbëdhjete (15) ditëve pune nga data kur Komisioni ia ka dorëzuar njoftimin dhe raportin e ZPD-së, mund të deklarohet më shkrim tek Komisioni lidhur me përgjegjësinë e tij. Deklarimi duhet të jetë i qartë nëse pranohet apo mohohet përgjegjësia disiplinore dhe mund të paraqet faktet apo argumentet për të mbështetur pozitën e tij apo saj ligjore.

9.3 Në rast se prokurori autorizon një avokat për ta përfaqësuar, informatat kontaktuese të avokatit duhet të ia dërgoj menjëherë sekretarit.

Neni 10

Përgatitjet për seancën disiplinore

10.1 Komisioni disiplinor nuk do ta fillojë procedurën në qoftë se ka kaluar afati një (1) vjeçar nga njoftimi i pranuar nga Zyra e Prokurorit Disiplinor, për shkeljen e supozuar dhe dy (2) vite nga dita shkeljes së supozuar.

10.2 Palët do të njoftohen me shkrim nga sekretari lidhur me datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës disiplinore. Palëve mund t'ju kërkohet të ofrojnë një listë të dëshmitarëve të mundshëm për Komisionin, jo më vonë së shtatë (7) ditë pune para seancës disiplinore. Njoftimet do të lëshohen në emër të Kryesuesit dhe më autorizim të tij njoftimin mund ta nënshkruaj sekretari.

10.3 Sekretari i fton dëshmitarët dhe dëshmitarët ekspertë të propozuar nga cilado palë në procedurë, për seancë disiplinore, ashtu siç urdhërohet nga Komisioni,

përkatësisht nga Kryesuesi. Njoftimet do të lëshohen në emër të Kryesuesit dhe me autorizim të të njëjtit, ato mund t'i nënshkruaj sekretari.

10.4 Dosja e lëndës dhe dokumentet tjera të nevojshme do t'ju dërgohen anëtarëve të Komisionit, jo më vonë se pesë (5) ditë para datës së caktuar të seancës. Anëtarët janë të obliguar ta nënshkruajnë konfirmimin për pranimin e njoftimit për seancën disiplinore dhe pranimin e dosjes së ofruar nga sekretari.

Neni 11

Komunikimi me palë

11.1 Parimisht, shkresat u dorëzohen personalisht prokurorit dhe përfaqësuesit të ZPD-së. Mjete të komunikimit me palë konsiderohen, telefoni, email-i, faksi dhe përmes postës.

11.2 Sekretari e kontakton në telefon prokurorin dhe shqyrton mundësin nëse prokurori mund të vijë në zyrat e komisionit për tija dorëzuar personalisht shkresat.

11.3 Në raste se nuk arrihet pajtimi, dërgimi i shkresave mund të bëhet me email, faks dhe në fund me postë në: në vendbanimin ose në vendqëndrimin ose në vend të punës ose në zyrën a përfaqësuesit të palës.

11.4 Për çdo korrespondencë sekretari mban evidencë.

Neni 12

Konflikti i interesit

12.1 Kryesuesi dhe anëtarët e komisionit janë të obliguar të deklarojnë nëse ekziston konflikti i mundshëm i interesit. Në rast se ekziston, atëherë ata janë të obliguar që menjëherë ta njoftojnë Kryesuesin e KPK-së.

12.2 Palët në procedurë kanë të drejtë që të kërkojnë përjashtimin e një ose më shumë anëtarëve mbi bazën e konfliktit të mundshëm të interesit. Një kërkesë e tillë i paraqitet komisionit. Komisioni ndërpret seancën dhe çështjen e dërgon tek Kryesuesi i KPK-së.

12.3 Kryesuesi i KPK-së në rast se konstaton ekzistimin e konfliktit të interesit, menjëherë ndërmerr masat për ta zëvendësuar anëtarin që ka konflikt interesi me një anëtar tjetër. Per pranim apo refuzim te kerkeses Kryesuesi i KPK-së merr vendim me shkrim.

12.4 Kundër vendimit te kryesuesit te KPK-së nuk mund të ushtrohet ankesë e veçantë por mund të jetë një nga arsyet ankimore ndaj vendimit përfundimtar të KPK-së.

12.5 Kryesuesi i KPK-së vendos për çështjen jo më vonë së 5 ditë pune nga dita e pranimit të kërkesës.

Neni 13

Incizimi i seancës disiplinore

13.1 Seanca mund incizohet më audio/video incizim. Incizimet do të behën në të njëjtën mënyrë siç bëhet incizimi i mbledhjeve të KPK-së.

13.2 Incizimet e seancave disiplinore do të shërbejnë si procesverbal zyrtar në procedurë.

13.3 Me pëlqimin e anëtarëve prezent në seancë, incizimi mund të ndërpritet shkaku i mosfunksionimit të pajisjeve. Në rastet e tilla, Kryesuesi periodikisht gjatë rrjedhës së seancës dëgjimore do të dikton atë pjesë që duhet të përfshihet në procesverbalin.

13.4 Incizimi do të jetë konfidencial përpos kur kërkohet për qëllime të ankesës në Këshill.

13.5 Palët procedurale kanë të drejtë të kërkojnë një kopje të transkriptit të incizimit dhe të procesverbalit. Sekretari në koordinim me Kryesuesin do të sigurojë nga një kopje të gjitha palëve brenda pesë (5) ditëve pas paraqitjes së kërkesës.

13.6 Sekretari do të kujdeset për ruajtjen e procesverbalit.

Neni 14

Zhvillimi i seancës

14.1 Seanca disiplinore zhvillohet në harmoni me nenin 26 të Ligjit. Kjo rregullore përcakton procedura të detajuara për zhvillimin e seancës, si në vijim:

14.2 Komisioni mund të hedh poshtë rekomandimin për iniciimin e procedurës disiplinore pa seance dëgjimore për arsyet si në vijim:

1. Ka arritur parashkrimi për shkeljen e supozuar disiplinore
2. Kur prokurori gjatë zhvillimit të procedurës disiplinore vdes
3. Me rastin e pensionimit ose dorëheqjes procedura disiplinore pushohet

14.3 Kryesuesi e hap seancën dhe deklaron:

14.4 Emrin e lëndës,

14.5 Numrin e dosjes,

14.6 Datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës,

14.7 Përbërjen e anëtarëve të pranishëm,

14.8 Palët në procedurë,

- 14.9 Përfaqësuesit e pranishëm të palëve në procedurë, nëse ka të tillë,
14.10 Zyrtarët tjerë të pranishëm të Sekretariatit të KPK-së, nëse ka të tillë,
14.11 Pjesëmarrës tjerë të pranishëm, më leje nga Komisioni Disiplinor, nëse ka të tillë.

14.3 Kryesuesi do të konstatojë nëse palët pajtohen rreth përbërjes së Komisionit dhe janë të gatshëm për të vazhduar seancën. Në rast mospajtimesh veprohet sipas dispozitave të nenit 10 të kësaj rregullore.

14.4 Nëse palët e njoftuar me kohë nuk paraqitet në seancë, paneli mund ta vazhdojë seancën dhe të marrë vendim. Nëse ndonjëra palë paraprakisht ja paraqet komisionit arsyet për mosparaqitje në seancë dhe komisioni e konsideron atë të justifikueshme, seanca shtyhet.

14.5 Secila palë do të ketë mundësinë të jap fjalën hyrëse. Kryesuesi mund të kërkojë kufizim të caktuar kohor të fjalës hyrëse.

14.6 Kryesuesi ia jep fjalën përfaqësuesit të ZPD-së i cili prezanton një përmbledhje të shkurtër të raportit.

14.7 Më pas, kryesuesi ia jep fjalën prokurorit i cili deklarohet shkurtimisht përkitazi me përgjegjësinë disiplinore.

14.8 Në çdo kohë gjatë procedurës, prokurori mund të pranojë se ka bërë shkelje disiplinore të paraqitura në raport. Komisioni nxjerr vendim për një pranim të tillë dhe mund ta marrë parasysh pranimin si faktor lehtësues për përcaktimin e çfarëdo mase disiplinore.

Neni 15

Procedura e paraqitjes së dëshmive

15.1 Përfaqësuesi i ZPD-së fillimisht do të paraqesë të gjitha provat dhe dëshmitarët që mbështesin pohimet e parashtruara në raport.

15.2 Prokurori do të paraqesë të gjitha provat dhe dëshmitarët për të kundërshtuar pohimet e parashtruara në raport.

15.3 Secila palë në procedurë ka të drejtë të paraqesë prova të reja nëse e konsideron si të domosdoshme për të vërtetuar gjendjen faktike.

15.4 Komisioni vendos për çdo propozim të palëve.

15.5 Kryesuesi dhe anëtarët e tjerë mund t'i shtrojnë pyetje palëve procedurale dhe dëshmitarëve.

15.6 Palët kanë të drejtë të marrin dhe të shikojnë kopjet e çfarëdo dokumenti që i paraqitet Komisionit si provë dhe mund ta kundërshtojnë atë. Komisioni vendosë nëse dëshmia apo prova e paraqitur do të pranohet. Nëse pranohet, dokumenti do të jetë pjesë e shkresave të lëndës dhe do të numërohet si p.sh. #1, #2. etj. dhe nuk është e nevojshme që për procesverbal të lexohet i tërë dokumenti.

15.7 Nëse Komisioni beson se propozimi për dëshmitar apo provat shtesë do t'i ndihmojë atyre në marrjen e vendimit meritör, atëherë Kryesuesi mund të shtyjë seancën për të thirrur dëshmitarët shtesë apo për të kërkuar prova shtesë. Shtyerja nuk duhet të jetë më e gjatë se 10 ditë pune.

15.8 Me përmbylljen e administrimit të provave palët mund të japin fjalën përfundimtare.

15.9 Fjala përfundimtare mund t'i referohet dëshmive, provave tjera të pranuara, dispozitave në fuqi të Kodeve të Etikës dhe ligjit të aplikueshëm. Fjalën përfundimtare, së pari do ta paraqesë përfaqësuesi i ZPD-ës, pastaj, prokurori përveç nëse Komisioni udhëzon ndryshe.

15.10 Varësisht nga rrethanat e rastit disiplinor, ZPD ka të drejtë të propozoj suspendimin e prokurorit sipas nenit 24 të Ligjit, deri në vendosjen përfundimtare të çështjes.

15.11 Palët mund të paraqesin argument kundërshtues edhe gjatë dhënies së fjalës përfundimtare. Më kërkesën e Komisionit palët janë të obliguara t'i përgjigjen argumenteve të parashtruara. Palët kanë të drejtë që fjalën përfundimtare ta paraqesin me shkrim por jo më vonë se në përfundim të seancës dëgjimore.

15.12 Nëse dëshmitë e prezantuara ofrojnë ndonjë ndryshim në gjendjen faktike krahasuar me ato që janë prezantuar në raport, apo nëse gjatë seancës kuptohet se është bërë shkelje disiplinore e re nga prokurori, ZPD mund të kërkojë që:

15.12.1 raporti të ndryshohet ose plotësohet gojarisht gjatë seancës;

15.12.2 seanca të shtyhet, në mënyrë që të hartohet një raport i ri.

15.13 Pas përfundimit të fjalës përfundimtare palët njoftohen se seanca disiplinore përfundoi dhe se vendimet me shkrim do t'i marrin brenda afatit ligjor të paraparë.

Neni 16

Këshillimi dhe votimi i komisionit disiplinor

16.1 Në të njëjtën ditë pas përfundimit të seancës disiplinore, komisioni mban një seancë të mbyllur ku vendos për çështjen e shqyrtuar në seancën disiplinore.

- 16.2 Komisioni mund ta shtyjë këshillimin dhe votimin për një ditë tjetër për shkaqe të arsyeshme por jo më vonë se 7 ditë pune, pas mbajtjes së seancës disiplinore.
- 16.3 Komisioni shqyrton rastet në seanca të mbyllura. Vetëm sekretari mund të jetë prezent në cilësinë e procesmbajtësit. Pjesëmarrja e personave tjerë nuk lejohet përveç në rastet kur kërkohet ndihma e përkthyesit.
- 16.4 Komisioni do të vendos më shumicë të votave për secilën shkelje të paraqitur në raport, veç e veç. Nëse gjendet së prokurori ka kryer sjellje të pahijshme siç është përcaktuar në nenin 24 të Ligjit, Komisioni do ti shqiptoj njërin nga sanksionet e parapara në nenin 27 të Ligjit. Gjithashtu, me qëllim të pengimit të dëmtimit të besimit të publikut në sistemin prokurorial, komisioni duhet të vlerësoj nëse ekzistojnë rrethana të arsyeshme për suspendimin e prokurorit sipas nenit 27 të ligjit, deri sa të vendoset lënda në shkallë të dytë.
- 16.5 Në procesverbal shënohet mendimi i kundërt i ndonjërit anëtar.
- 16.6 Procesverbali mbi shqyrtimin dhe votimin do të përpilohet nga sekretari. Procesverbali do të nënshkruhet nga anëtarët dhe do të mbyllet në një zarf të vulosur. Ky dokument është konfidencial, jopublik dhe do t'i bashkëngjitet dosjes.
- 16.7 Vendimi në formë të shkruar i Komisionit do të përgatitet brenda 15 ditëve të punës duke filluar nga data e seancës për këshillim dhe votim. Në raste të arsyeshme dhe me miratimin e Kryesuesit të KPK-së, afati për përpilimin e vendimit mund të zgjatët për 15 ditë të tjera.
- 16.8 Vendimi përmban hyrjen, dispozitivin, arsyetimin dhe këshillën juridike. Vendimin e nënshkruan të tre anëtarët e komisionit. Në rast se një anëtar ka mendim ndryshe, ai nuk e nënshkruan vendimin por e përgatit një opinion të ndarë, i cili si shtojcë bëhet pjesë përbërëse e vendimit.
- 16.9 Nga një kopje e vendimit do t'u dërgohet palëve pa vonese. Konfirmimin mbi pranimin e vendimit do ta siguroj sekretari, më të cilin dëshmohet së palët kanë pranuar vendimin e Komisionit dhe do t'i bashkëngjitet dosjes.

Neni 17 **Korrigjimi i gabimeve të vendimeve**

Sipas detyrës zyrtare, apo me kërkesë të ndonjëres palë, komisioni mund t'i korrigjojë gabimet e natyrës teknike të vendimeve të komisionit.

Neni 18 Masat disiplinore

18.1 Komisioni duke u bazuar në nenin 27 të Ligjit, mund të shqiptojë masat disiplinore si në vijim:

- 18.1.1 qortim;
- 18.1.2 qortim me urdhër për ndërmarrje të veprimeve korrigjuese;
- 18.1.3 zvogëlim i përkohshëm i pagës deri në pesëdhjete për qind (50%) deri në gjashtë muaj, duke marrë parasysh natyrën e sjelljes së pahijshme;
- 18.1.3 ulje në detyrë brenda sistemit prokurorial apo;
- 18.1.4 propozim për largim nga detyra e Prokurorit të Shtetit.

18.2 Komisioni shqipton sanksionin që është në përputhje me rrethanat, nivelin e përgjegjësisë dhe pasojat e sjelljes së pahijshme.

Neni 19 Suspendimi

19.1 Komisioni mund të suspendoj një prokuror jo me shume se 6 muaj, përveç rasteve kur ndaj tij zhvillohet procedurë penale, është ngritur akti akuzues dhe suspendimi vazhdon deri në përfundim të procedurës penale, përkatësisht nxjerrja e aktgjyqimit të formës së prerë.

19.2 KD me qellim të ruajtjes së besimit të publikut për sistemin prokurorial, duhet të veproj me urgjencë në rastet:

- 19.2.1 Kur ndaj prokurorit ngritet aktakuzë;
- 19.2.2 Kur prokurorit i caktohet masa e paraburgimit ose arresti shtëpiak;

19.3 Në rastet e parapara me dispozitat 19.2.1 dhe 19.2.2, atëherë KD mund të suspendoj menjëherë prokurorin. KD njofton menjëherë KPK dhe ZPD për suspendimin e prokurorit.

19.4 Vendimi i KD për suspendimin e prokurorit paraqet vetëm masë të përkohëshme deri në zhvillimin e procedurës zyrtare disiplinore nga ZPD dhe Komisioni Disiplinor.

19.5 Në rastet kur prokurori është i suspenduar ndërsa lirohet nga akuzat në përfundim të procedurës disiplinore, ai apo ajo me vendim të Këshillit kthehet në zyrën e mëhershme prokuroriale.

Neni 20

Ankesat ndaj vendimeve disiplinore

20.1 Ankesat kundër vendimeve të Komisionit mund t'i dorëzohen KPK-së përmes Kryesuesit. Asnjë anëtar i KPK-së që ka marrë pjesë në procedurat e Komisionit nuk mund të merr pjesë në shqyrtimin e ankesës.

20.2 Prokurori dhe ZPD-ja mund të paraqesin ankesë në Këshill kundër vendimit të Komisionit brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga pranimi i vendimit.

20.3 Afati për paraqitjen e ankesës sipas këtij neni mund të vazhdohet me kusht që kërkesa për vazhdim të afatit kohor të jetë parashtruar në Këshill brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të cekura. Këshilli nuk pranon vazhdimin e afatit kohor të kërkuar dhe ankesën e parashtruar pas pesëmbëdhjetë (15) ditëve, përveq nëse vonesa është bërë si rezultat i rrethanave të jashtëzakonshme apo katastrofave.

20.4 Ankesa e ushtruar brenda këtyre afateve kohore e pezullon ekzekutimin e vendimit disiplinor siç parashihet në nenin 27 të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Neni 21

Arsyet për ankesë

21.1 Ankesa në formë të shkruar i dorëzohet KPK-së brenda afateve kohore të parapara me këtë rregullore.

21.2 Ankesa mund të ushtrohet për shkak të:

21.3 shkeljes së ligjit apo akteve nënligjore të zbatueshme për prokurorë

21.3.1 vërtetimit të gabuar apo provave jo të plota të situatës faktike dhe,

21.3.2 shkeljes së procedurës disiplinore.

21.4 Ankesa përmban:

21.4.1 identifikimin e ankuesit;

21.4.2 vendimin që atakohet;

21.4.3 datën e pranimi të vendimit dhe,

21.4.4 bazën specifike të ankesës.

Neni 22

Procedura lidhur me ankesën

- 22.1 Ankesat i pranon Sekretariati i KPK-së i cili do të jetë përgjegjës për njoftimin dhe dorëzimin e ankesës fillimisht tek Kryesuesi KPK-së dhe më pas tek KPK.
- 22.2 Palët do të informohen se mund të prezantojnë dëshmi të reja vetëm, kur KPK e përcakton si të rëndësishme dhe me interes për çështjen.
- 22.3 KPK mund të vendos përkitazi me ankesën në bazë të parashtresave të dorëzuara më shkrim.
- 22.4 Këshilli gjatë vendosjes për ankesë mund të refuzojë ankesën, vërtetojë ose ndryshojë vendimin e Komisionit Disiplinor.
- 22.5 Palët mund të propozojnë që të mbahet seancë dëgjimore për shqyrtimin e ankesës.
- 22.6 Kryesuesi i Këshillit e shqyrton dhe vendos mbi kërkesën e palëve për të marr pjesë në seancë dëgjimore kur vendos sipas ankesës. Nëse Kryesuesi i KPK-së vendos që të mbajë seancë dëgjimore, atëherë bëhet njoftimi i palëve në procedurë.
- 22.7 Palët në procedurë, njoftohen nga Sekretari për datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës dëgjimore. Palët gjithashtu njoftohen për të drejtën në përfaqësim ligjor dhe të drejtën për të paraqitur mbrojtjen e tyre. Njoftimi dërgohet së paku pesë (5) ditë pune para mbajtjes së seancës dëgjimore.
- 22.8 Këshilli mund të kërkoj nga ZPD-ja që të zhvilloj hetime shtesë për disa çështje të ngritura gjatë procedurës, e për të cilat mungojnë informacionet e nevojshme. Për këtë arsye Këshilli mund ta pezulloj rastin derisa të dorëzohet informata/raporti i kërkuar.
- 22.9 Pezullimi i procedimeve nuk mund të tejkaloj periudhën prej një (1) muaj, nga data e pezullimit.
- 22.10 Në rastin kur ZPD ka lejuar parashkrimin e lëndës, ose shtyrjen e dërgimit të saj në gjykim tek Komisioni Disiplinor, gjë që rezulton ta pamundësojë këtë të fundit për ta shqyrtuar atë sipas këtij ligji, Komisioni detyrohet ta njoftojë Këshillin për një lëshim të tillë të ZPD. Mbi një lëshim të tillë, Këshilli kërkon përgjegjësi zyrtare nga ZPD dhe nëse për një gjë të tillë nuk merret përgjigje e arsyetuar, një lëndë të tillë detyrueshëm ia adreson Prokurorit të Shtetit për hetim eventual të keqpërdorimit të detyrës zyrtare nga ZPD.

Neni 23
Afati për shqyrtimin e ankesës

Bazuar në veprimet e Komisionit, KPK i shqyrton dhe vendos cilëndo ankesë brenda tre (3) muajsh nga data e paraqitjes së ankesës.

Neni 24
Refuzimi i ankesës

24.1 Këshilli mund të refuzojë ankesën, pa mbajtur farë seance dëgjimore, brenda pesë (5) ditëve, nëse vërtetohet që:

24.1.1 ankuesi nuk është njëra nga palët më të drejtë ankimi kundër vendimit;

24.1.2 ankesa nuk përmban një apo më shumë arsye që kërkojnë paraqitjen e ankesës;

24.1.3 ankesa nuk është paraqitur në afatin e përcaktuar kohor.

24.2 Këshilli nxjerr vendim mbi ankesën. Anëtarët e KPK-së të cilët kanë marrë pjesë në Komision lidhur me vendosjen e rastit përjashtohen.

24.3 Nëse ndonjëra palë edhe pse të informuara për seancën disiplinore, nuk paraqitet, KPK-së mund të dëgjon palën prezentë dhe në bazë të shkresave dhe dokumenteve tjera merr vendim për rastin.

24.4 Në raste të veçanta kur pala e informuar më kohë nuk paraqitet në seancën disiplinore, KPK mund të caktojë një seancë tjetër, nëse konsideron se kjo do të i kontribuojë interesit të drejtësisë ose këto shkaqe për palën kanë qenë të pashmangshme.

24.5 Vendimi i KPK-së do të jetë me shkrim dhe do të përmbajë arsyetimin e vendimit.

Neni 25
Shkarkimi i prokurorit nga detyra

25.1 Në bazë të procedurave disiplinore, KPK-ja vendos nëse sjellja e pahijshme e një prokurori arsyeton shkarkimin nga detyra.

25.2 Çdo propozim nga KPK-së për shkarkim të një prokurori duhet të përfshijë arsyet me shkrim për një propozim të tillë dhe konkluzionet e Komisionit.

25.3 Propozimi i KPK-së për shkarkim i dorëzohet Presidentit dhe prokurorit në fjalë brenda pesëmbëdhjete (15) ditësh pas vendimit përfundimtar.

25.4 Presidenti vendos mbi propozimin e KPK-së për shkarkim, në pajtim me Kushtetutën, ligjin e aplikueshëm dhe këtë rregullore.

25.5 Para zbatimit të vendimit të tillë, prokurori njoftohet zyrtarisht brenda një afati të arsyeshëm nga KPK-së lidhur me vendimin e Presidentit për miratimin apo mosmiratimin e shkarkimit të tij nga detyra.

Neni 26

Regjistrimi dhe publikimi i vendimeve përfundimtare disiplinore

26.1 Procedura disiplinore është jo publike.

26.2 KPK-ja do të mbaj një regjistër për të gjitha rastet që publikohen. Regjistri publik përmban:

26.2.1 Numrin e lëndës;

26.2.2 Llojin dhe natyrën e shkeljes;

26.2.3 Datën kur është parashtruar lënda;

26.2.4 Nivelin dhe vendndodhjen e prokurorisë;

26.2.5 Vendimet dhe sanksionet;

26.2.6 Ankesat e parashtruara dhe,

26.2.7 Vendimin përfundimtar.

26.3 Regjistri publik do të publikohet në ueb faqen e KPK-së dhe do të azhurnohet periodikisht.

Neni 27

Gjuha zyrtare

Komisioni do ta zhvilloj veprimtarin e tij në harmoni me Ligjin për përdorimin e gjuhëve në Republikën e Kosovës.

Neni 28

Vula

Komisioni gjatë punës së tij e përdorë vulën e KPK-së.

Neni 29

Dispozitat përfundimtare

28.1 Me hyrjen në fuqi të kesaj rregullore, shfuqizohet Rregullorja nr.278/2011 e dt.27.04.2011 për punën e Komisionit Disiplinor.

Neni 30
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hynë në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Prishtinë, më 05 nëntor 2015

Këshilli Prokurorial i Kosovës
Kryesues Aleksandër Lumezi

The image shows a circular official stamp of the Republic of Kosovo, Office of the Prosecution Council. The text in the stamp includes "REPUBLIKA E KOSOVES", "Këshilli Prokurorial i Kosovës", and "Prokuroria e Përgjithshme". Overlaid on the stamp is a handwritten signature in blue ink, which appears to be "A. Lumezi".